FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 78

Tiranë – E martë, 19 maj 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 41/2015 datë 16.4.2015	Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare/PPP, me objekt ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit, ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërisë "China State Construction Company".....	3461
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 375, datë 6.5.2015	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit/të posaçme.....	3462
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 378, datë 6.5.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", të ndryshuar.....	3464
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 379, datë 7.5.2015	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2015, në njësitë e qeverisjes qendrore", të ndryshuar, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitin 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban..	3465
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 380, datë 6.5.2015	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve të Brendshme, për nënprefekturën Pukë, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 1700 m^2, brenda territorit të pronës me numër rendor 531, me emërtim "Ish-reparti ushtarak nr. 2240, shkollë instruksioni, ofiçina e brigadës së këmbësorisë", me vendndodhje në Pukë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.....	3465
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 6.5.2015	Për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Forumin Ekonomik të Vjenës.....	3468

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 6.5.2015 — Për një ndryshim në vendimin nr. 710, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve e të studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2014 - 2015"..... 3468

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 6.5.2015 — Për miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve në risk nga atmosferat shpërthyese" 3469

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 385, datë 6.5.2015 — Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të objektit "Shkolla 8-vjeçare Palasë" dhe për një ndryshim në vendimin nr. 362, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi të bashkisë së Himarës"..... 3475

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 6.5.2015 — Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Ujërave..... 3477

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 387, datë 6.5.2015 — Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura..... 3479

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 388, datë 6.5.2015 — Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së"..... 3483

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 6.5.2015 — Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza e Madhe Tiranë" (segmenti Kopshti Botanik - Sauk i Vjetër, (shtesat)"..... 3484

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 6.5.2015 — Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, Fakulteti Filologjik - Unaza e Madhe Tiranë (objekt+truall)"..... 3485

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 6.5.2015 — Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës lidhëse midis rrugëve "Qemal Stafa" dhe "Esat Bordi", si dhe ndërtimi i lulishtes në pjesën jugore të bulevardit "Aqif Pasha", te "Xhamlliku para Sahatit", në bashkinë e Elbasanit..... 3487

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 7.5.2015 — Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, për mbulimin e shpenzimeve të strukturave të angazhuara për pastrimin e zonave bregdetare..... 3490

LIGJ
Nr. 41/2015

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR NEGOCIMIN DHE LIDHJEN E KONTRATËS KONCESIONARE/PPP, ME OBJEKT NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E RRUGËS SË ARBRIT, NDËRMJET SHTETIT SHQIPTAR DHE SHOQËRISË "CHINA STATE CONSTRUCTION COMPANY"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton procedurën e veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare /PPP ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërisë "China State Construction Company" për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit, si përjashtim nga procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

Neni 2
Procedura e negocimit

Procedura e negocimit për lidhjen e kontratës ndiqet nga Komisioni i Negocimit të Kontratës, kryesuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe me anëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Drejtësisë dhe Avokaturës së Shtetit.

Komisioni i Negocimit të Kontratës asistohet nga një konsulent i huaj, i cili bën vlerësimet ligjore dhe financiare të propozimit të paraqitur dhe kontratës që do të lidhet. Përzgjedhja e konsulentit bëhet nga Avokatura e Shtetit, në përputhje me vendimin nr. 392, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale"".

Komisioni i Negocimit të Kontratës negocion me shoqërinë "China State Construction Company" propozimin e paraqitur pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe përpilon projektkontratën finale, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave.

Projektkontrata, e shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda një afati prej 60 ditësh nga nisja e negociatave, i dërgohet për nënshkrim Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

Neni 3
Nënshkrimi i kontratës

Nënshkrimi i kontratës bëhet nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Ministri i Financave dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes pas dorëzimit të projektkontratës dhe relacionit përmbyllës të negociatave nga komisioni negociues.

Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Ministri i Financave dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes mund t'i kërkojnë komisionit negociues rishikimin e projektkontratës.

Komisioni i Negocimit të Kontratës duhet të rinegociojë dhe t'u paraqesë për nënshkrim ministrave projektkontratën, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave brenda afatit kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga data e kthimit.

Neni 4
Miratimi i kontratës

Komisioni i Negocimit të Kontratës harton projektligjin për miratimin e kontratës dhe ia dërgon atë për miratim Këshillit të Ministrave, brenda afatit kohor prej 10 ditësh nga data e nënshkrimit nga tre ministrat.

Kontrata miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Data e hyrjes në fuqi të kontratës konsiderohet data e hyrjes në fuqi të ligjit pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.4.2015

KRYETARI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 375, datë 6.5.2015

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT/TË POSAÇME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit/të posaçme, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE PËR HEQJEN E NDËRSJELLË TË VIZAVE TË HYRJES PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT/TË POSAÇME

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe, në vijim të quajtura "Palët",

me dëshirën për të nxitur zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe dhe bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve,

duke shprehur gatishmërinë e tyre për të përjashtuar shtetasit e të dyja vendeve të tyre që mbajnë pasaporta diplomatike, speciale dhe shërbimi nga viza e hyrjes për të hyrë në territorin e njëri-tjetrit,

duke pasur parasysh Konventën e Vjenës "Për marrëdhëniet diplomatike", të vitit 1961 dhe Konventën e Vjenës "Për marrëdhëniet konsullore", të vitit 1963,

kanë rënë dakord, si më poshtë:

Neni 1

1. Pasaportat në fuqi në Republikën e Shqipërisë: diplomatike dhe të shërbimit
2. Pasaportat në fuqi në Emiratet e Bashkuara Arabe: pasaportat diplomatike dhe të posaçme.

Neni 2

1. Të dyja Palët do të lejojnë shtetasit e njëri-tjetrit me pasaporta të specifikuara në nenin 1, të hyjnë, të dalin dhe në transit përmes territoreve të tyre përkatëse pa vizë hyrjeje dhe pa tarifë.
2. Emiratet e Bashkuara Arabe do të lejojnë shtetasit e Republikës së Shqipërisë me pasaporta diplomatike dhe të shërbimit të qëndrojnë në territorin e tyre për një periudhë jo më të gjatë se 90 ditë.
3. Republika e Shqipërisë do të lejojë shtetasit e Emirateve të Bashkuara Arabe me pasaporta diplomatike dhe të posaçme të qëndrojnë në territorin e saj për një periudhë jo më të gjatë se 90 ditë.

Neni 3

Kur secila nga të dyja Palët emëron ndonjë nga qytetarët e saj në misionet e saj diplomatike dhe konsullore pranë Palës tjetër kontraktuese, ajo do të informojë Palën tjetër për emërimin para mbërritjes së të emëruarit në territorin e saj.

Neni 4

1. Të dyja Palët deklarojnë të kenë shkëmbyer modele të pasaportave të tyre, të përcaktuara në nenin 1, nëpërmjet kanaleve diplomatike para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.
2. Në rast të ndonjë ndryshimi të bërë pasaportave të secilës Palë, të lëshuara prej saj,

ajo do t'i kalojë Palës tjetër modelin e pasaportës së re para datës së prezantimit të saj.

3. Nëse cilado Palë sjell ndryshime në rregulloret e saj të brendshme që kanë të bëjnë me pasaportat diplomatike, të shërbimit/speciale, ajo duhet të informojë Palën tjetër mbi këto ndryshime.

Neni 5

Shtetasit e secilës Palë, që mbajnë pasaporta diplomatike ose shërbimi/speciale, nuk lejohen që të punojnë, të angazhohen në ndonjë profesion apo të studiojnë në vendin e njëri-tjetrit, pa respektuar rregullat dhe rregulloret në fuqi në të dyja vendet që kanë të bëjnë me këto aktivitete.

Neni 6

1. Shtetasit e secilës Palë mund të hyjnë në territorin e Palës tjetër vetëm nëpërmjet pikave kufitare të caktuara për trafikun ndërkombëtar të udhëtarëve.

2. Shtetasit e secilës Palë që mbajnë pasaporta të specifikuara në nenin 1 do t'u përmbahen rregullave dhe rregulloreve në fuqi në territorin e Palës tjetër gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre.

Neni 7

l. Të dyja Palët rezervojnë të drejtën e refuzimit të hyrjes në territorin e tyre ose të qëndrimit aty, për çdo shtetas të Palës tjetër, mbajtës i pasaportës diplomatike ose të shërbimit/speciale në bazë të rregulloreve të tyre të brendshme.

2. Nëse një shtetas i secilës Pale humb apo dëmton pasaportën e tij/saj, apo nëse ajo është dëmtuar në territorin e Palës tjetër, ai/ajo do të informojë autoritetet kompetente të kësaj Pale për të ndërmarrë veprimin e tyre të duhur. Misioni diplomatik apo konsullor në fjalë, do të nxjerrë një pasaportë ose dokument udhëtimi të ri për shtetasin e saj dhe do të informojë autoritetet përkatëse të Palës pritëse.

Neni 8

Të dyja Palët shprehin gatishmërinë e tyre për të garantuar nivelin më të lartë të mbrojtjes së pasaportave dhe dokumenteve të udhëtimit kundër falsifikimit. Ata do t'i shqyrtojnë për pajtueshmëri me standardet minimale të sigurisë për dokumente udhëtimi të lexueshme nga makineria, të rekomanduara nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (I.C.A.O.).

Neni 9

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e të dyja Palëve që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat njëra ose të dyja janë palë.

Neni 10

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy palëve që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me konsultime dhe bisedime ndërmjet tyre nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 11

l. Për çdo ndryshim në këtë Marrëveshje do të bihet dakord reciprokisht nga të dyja Palët dhe do të bëhet me shkëmbim të notave zyrtare nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi, siç parashikohet në nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Secila Palë mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, tërësisht ose pjesërisht, për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik. Një pezullim i tillë, si dhe rifillimi i zbatimit të Marrëveshjes do t'i njoftohet menjëherë Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 12

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të fundit nga ana e të dyja Palëve që njoftojnë përfundimin e procedurave të duhura, të brendshme për hyrjen e saj në fuqi. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar, përveç nëse ndonjëra Palë njofton Palën tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike për qëllimin e saj për ta përfunduar atë. Ky përfundim do të hyjë në fuqi pas 30 ditëve nga data e njoftimit zyrtar të përfundimit.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike.

Në rast dyshimi, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Nënshkruar në Abu Dhabi, më 13.4.2015.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ditmir Bushati
Ministër i Punëve të Jashtme

PËR QEVERINË E EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE
Abdullah bin Zayed Al Nahyan
Ministër i Punëve të Jashtme

VENDIM
Nr. 378, datë 6.5.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas ndarjes me emërtimin "Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit" shtohet ndarja me emërtimin "Ministria e Zhvillimit Urban", sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Emërtimi "Komisioni i dhënies së licencave profesionale", në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëvendësohet me emërtimin "Komisioni i dhënies së licencave profesionale në fushën e zbatimit në ndërtim";

c) Emërtimi "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" zëvendësohet me emërtimin "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes".

2. Në pikën 5, të vendimit, emërtimi "Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit" zëvendësohet me emërtimin "Ministria e Zhvillimit Urban".

3. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela

Institucioni buxhetor	**Emërtesa e bordit/këshillit/komisionit**	**Numri maksimal i pagesave në një vit**	**Përbërja**		**Shpërblim kryetari (lekë)**	**Shpërblim anëtari (lekë)**
			Kryetari	**Nr. i anëtarëve**		
Ministria e Zhvillimit Urban	Komisioni i dhënies së licencave profesionale në fushën e studimit, të projektimit dhe të mbikëqyrjes e kolaudimit	12	1	6	8.000	7.000
	Komisioni i dhënies së licencave profesionale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme	12	1	6	8.000	7.000

VENDIM
Nr. 379, datë 7.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR. 11, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2015, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIN 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT URBAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11 e 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet "... 1 518 veta ...".

b) Në nënndarjen 20, "Ministria e Zhvillimit Urban", të lidhjes nr. 1, bashkëlidhur vendimit, shtohet nënndarja, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministrisë së Zhvillimit Urban, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në programin "Planifikimi urban dhe strehimi", i shtohet fondi prej 38 000 000 (tridhjetë e tetë milionë) lekësh, në zërin "Shpenzime korente", për mbulimin e shpenzimeve për pastrimin e bregdetit, për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

3. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha ditore	Periudha kohore
(20) Ministria e Zhvillimit Urban (Turizmit)	**300**			
Agjencia Kombëtare e Bregdetit	**300**	Punonjës pastrimi/mirëmbajtjeje	8 orë/ditë	15 maj - 15 shtator

VENDIM
Nr. 380, datë 6.5.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, PËR NËNPREFEKTURËN PUKË, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 1700 m^2, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS ME NUMËR RENDOR 531, ME EMËRTIM "ISH-REPARTI USHTARAK NR. 2240, SHKOLLË INSTRUKSIONI, OFIÇINA E BRIGADËS SË KËMBËSORISË", ME VENDNDODHJE NË PUKË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve të Brendshme, për nënprefekturën Pukë, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 1700 (një mijë e shtatëqind) m^2, brenda territorit të pronës me numër rendor 531, me emërtim "Ish-Reparti Ushtarak nr. 2240, shkollë instruksioni, ofiçina e Brigadës së Këmbësorisë", me vendndodhje në Pukë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për vendosjen në mjedise pune dhe për sistemimin e Repartit të PMNZSH-së në qytetin e Pukës.

2. Objektet dhe sipërfaqja e truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 1700 (një mijë e shtatëqind) m^2, pjesë e pronës me numër rendor 531, me emërtim "Ish-Reparti Ushtarak nr. 2240, shkollë instruksioni, ofiçina e Brigadës së Këmbësorisë", me vendndodhje në Pukë, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1691, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për prefektët në qarqe dhe administratën e prefektëve, nënprefektët dhe administratën e nënprefektëve dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (Drejtorisë së PMNZSH-së)", të ndryshuar.

3. Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nënprefekturës Pukë, u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e objekteve dhe të sipërfaqes së truallit funksional të pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Punëve të Brendshme, nënprefekti i Prefekturës Pukë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Plan-vendosja e Pronës Nr.531

'Ish Reparti Ushtarak nr.2240 Shkollë Instruksioni , Ofiçina BrK', Pukë

(Sip. dhe Objektet që kërkohen për kalim në përgjisi administrimi nga MM te MPB.)

SISTEMI KOORDINATAVE SHTETERORE

MIRATOHET
Komandant i Komandës Mbështetëse
Gjeneral Brigade Ylber DOGJANI

tjetërsuar

1 rrën.

2

rrën. 3

4

5

6

7 rrën.

8 rrën.

rrugë

Punuar Nëntor 2014

Shkalla 1:1000

Shpjeguese.
Sip. përgjithshme = 22776.4 m2
Sip. që kërkohet për kalim në administrim të MPBë = 1700 m2 (përfshi obj.nr. 2,3 4)
Objektet me nr.2,3,4 me sip. ndërtimi = 310.6 m2 (obj.nr.3 mënd)
Sip. që do të mbetet repartit = 21076.4 m2
Kufiri i reparti

Shënim:Kjo plan-vendosje u përgatit në zbatim të shkresës me nr.5413/4 dt. 06.11.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm të MM.
Sip. e kërkuar u përcaktua në terren nga përfaqësuesit e PMNZSH-së, Pukë dhe përfaqësuesit e Komandës Mbështetëse N/Kol. Ilmi DUHONI dhe Specialist Rifat HASA.
Mbi plan-vendosjen e marrë nga arkivi i I.GJ.I.U-së u mbivendos sipërfaqja e përcaktuar në terren.

PUNOI
ng.Albert MURATI

Përgj. Sek. R.Haxhiu

DREJTORI I IG.
N/Kol.Armir Ç.

VENDIM
Nr. 381, datë 6.5.2015

PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË FORUMIN EKONOMIK TË VJENËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Shqipërisë në Forumin Ekonomik "Vienna Economic Forum-Tirana Talks 2015".
2. Autorizohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të këtij Forumi, në shumën 23 000 (njëzet e tre mijë) euro.
3. Ky fond të përballohet nga buxheti i planifikuar për këtë Agjenci, për vitin 2015.
4. Lejohet AIDA të transferojë këtë fond në llogarinë e Forumit Ekonomik të Vjenës.
5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 382, datë 6.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 710, DATË 29.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2014 - 2015"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të nenit 57, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 29, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 15 e vendimit nr. 672, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"15. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për vitet e para, është data 31 dhjetor 2014, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitin e dytë e lart është data 15 nëntor 2014. Miratimi i bursave nga këshillat bashkiakë apo të komunës, për këtë vit shkollor, për të gjitha kategoritë e shkollave/institucioneve të arsimit të lartë, duhet të përfundojë deri në datën 30 prill 2015.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 384, datë 6.5.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË TË PUNËMARRËSVE NË RISK NGA ATMOSFERAT SHPËRTHYESE"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 42, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve në risk nga atmosferat shpërthyese", sipas tekstit dhe shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe të gjitha subjektet me personalitet juridik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet 1 (një) vit pas botimit.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË TË PUNËMARRËSVE NË RISK NGA ATMOSFERAT SHPËRTHYESE

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve në risk nga atmosferat shpërthyese.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet, për:

a) zonat që shërbejnë drejtpërdrejt për trajtimin mjekësor të pacientëve;

b) përdorimin e pajisjeve që punojnë me lëndë djegëse të gazta;

c) prodhimin, trajtimin, përdorimin, magazinimin dhe transportimin e eksplozivëve ose substancave kimikisht të paqëndrueshme;

ç) industritë e nxjerrjes së mineraleve;

d) mjetet e transportit tokësor, ujor dhe ajror, përdorimi i të cilave rregullohet me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, me përjashtim të mjeteve të transportit të synuara për përdorim në një atmosferë potencialisht shpërthyese.

3. Dispozitat e legjislacionit përkatës të shëndetit dhe të sigurisë në punë janë plotësisht të zbatueshme në të gjithë fushën e përmendur në pikën 1 të këtij neni, përveç rasteve kur ka një dispozitë më shtrënguese/ose më specifike në këtë rregullore.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

a) "Atmosferë shpërthyese", çdo përzierje me ajrin, nën kushtet atmosferike, të substancave të ndezshme në formën e gazrave, avujve, aerosoleve ose pluhurave, në të cilat, pasi ka ndodhur ndezja, djegia përhapet në të gjithë përzierjen e padjegur;

b) "Substancë e ndezshme", çdo lëndë e cila, kur përzihet me ajrin, mund të krijojë një atmosferë shpërthyese, përveç rasteve kur analiza e karakteristikave të saj tregon të kundërtën;

c) "Shpërthim", një reaksion i papritur oksidimi ose zbërthimi, që prodhon rritje të temperaturës ose të presionit apo të dyja në të njëjtën kohë;

ç) "Proces pune normal", situata kur instalimet përdoren brenda parametrave të projektimit të tyre.

[1] Ky vendim i Këshillit të Ministrave është përafruar plotësisht me direktivën 1999/92/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 16 dhjetor 1999, "Për kërkesat minimale për përmirësimin e mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit të punonjësve në risk nga atmosferët shpërthyese (direktiva e 15-të individuale, në kuptim të nenit 16(1) të direktivës 89/391/KE); numri CELEX 31999L0092, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 23, datë 28.1.2000, faqe 57.

SEKSIONI II
DETYRIMET E PUNËDHËNËSIT

Neni 3
Parandalimi i shpërthimeve dhe mbrojtja ndaj tyre

1. Punëdhënësi siguron parandalimin dhe mbrojtjen nga shpërthimet, duke marrë masa teknike dhe organizative të përshtatshme me natyrën e procesit të punës, në përputhje me parimet bazë të mëposhtme të renditura sipas përparësisë:

a) të parandalojë krijimin e atmosferave shpërthyese ose kur natyra e veprimtarisë nuk e lejon këtë;

b) të shmangë ndezjen e atmosferave shpërthyese;

c) të zvogëlojë efektet negative të një shpërthimi, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e punëmarrësve dhe personave të tjerë.

2. Kur është e nevojshme, masat e parandalimit dhe të mbrojtjes sipas pikës 1, të këtij neni, kombinohen dhe/ose plotësohen me masa të tjera kundër përhapjes së shpërthimeve.

3. Punëmarrësi rishikon rregullisht masat parandaluese dhe mbrojtëse, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, në periudhat e përcaktuara nga vetë ai dhe sa herë që ndodhin ndryshime të rëndësishme.

Neni 4
Vlerësimi i risqeve të shpërthimit

1. Punëdhënësi vlerëson çdo risk që krijohet nga atmosferat shpërthyese, duke marrë parasysh të paktën:

a) mundësinë e krijimit të atmosferave shpërthyese dhe kohëzgjatjen e tyre;

b) mundësinë që burimet e ndezjes, përfshirë shkarkimet elektrostatike, të jenë të pranishme dhe të bëhen aktive dhe efektive;

c) instalimet, substancat e përdorura, proceset dhe ndërveprimet e tyre të mundshme;

ç) shkallën e pasojave të parashikuara.

2. Risqet e shpërthimit vlerësohen në tërësi, duke marrë parasysh të gjitha aspektet e punës.

3. Në vlerësimin e risqeve të shpërthimit merren parasysh hapësirat që janë të lidhura ose mund të lidhen me vendet ku mund të krijohen atmosfera shpërthyese.

Neni 5
Vendet ku mund të krijohen atmosfera shpërthyese

1. Punëdhënësi, për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve e të personave të tjerë në vendet e punës ku mund të krijohen atmosfera shpërthyese, merr masat e nevojshme, në mënyrë që:

a) të klasifikojë vendet ku mund të krijohen atmosfera shpërthyese, sipas zonave në përputhje me shtojcën I;

b) të sigurohet që kërkesat minimale të sigurisë e të shëndetit në punë, të përcaktuara në shtojcën II, janë zbatuar në vendet e klasifikuara në shkronjën "a";

c) të pajisë me shenja dalluese, kur është e nevojshme, vendet ku atmosferat shpërthyese mund të krijohen në shkallë të tillë sa rrezikohet shëndeti dhe siguria e punëmarrësve, në burim dhe pikat e hyrjes në përputhje me shtojcën III, të kësaj rregulloreje;

ç) të sigurojë hartimin e një dokumenti me shkrim për mbrojtjen nga shpërthimi dhe përditësimin e tij në përputhje me nenin 7.

2. Kur atmosferat shpërthyese mund të krijohen në sasi të tilla që rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, punëdhënësi siguron mbikëqyrje të përshtatshme ose/dhe monitorim të vazhdueshëm nëpërmjet përdorimit të mjeteve teknike, në përputhje me vlerësimin e riskut gjatë pranisë së punëmarrësve.

Neni 6
Detyrimi për koordinim

Në rastet kur punëmarrës nga ndërmarrje të ndryshme janë të pranishëm në të njëjtin vend pune:

- secili punëdhënës është përgjegjës për të gjitha çështjet që janë nën kontrollin e tij;

- punëdhënësi përgjegjës për vendin e punës koordinon zbatimin e të gjitha masave dhe procedurave që lidhen me sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve;

- punëdhënësi përgjegjës pasqyron në dokumentin "Për mbrojtjen nga shpërthimi", të përcaktuar në nenin 7, të kësaj rregulloreje, qëllimin, masat dhe mënyrat e zbatueshmërisë së këtij koordinimi.

Neni 7

Dokumenti "Për mbrojtjen nga shpërthimi"

1. Në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 4, punëdhënësi siguron hartimin dhe përditësimin e dokumentit "Për mbrojtjen nga shpërthimi", i cili pasqyron, veçanërisht:

a) përcaktimin dhe vlerësimin e riskut për shpërthim;

b) marrjen e masave të përshtatshme, parandaluese dhe lehtësuese;

c) klasifikimin e vendeve në zona sipas shtojcës I;

ç) kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë, të përcaktuara në shtojcën II, sipas zonave;

d) projektimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen e vendit e të pajisjeve të punës, përfshirë edhe pajisjet paralajmëruese, duke marrë parasysh sigurinë;

dh) koordinimin e masave dhe procedurave sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje.

2. Dokumenti "Për mbrojtjen nga shpërthimi" hartohet përpara fillimit të punës dhe ndryshohet në rastet kur vendi, pajisjet ose organizimi i punës pësojnë ndryshime, zgjerime ose shndërrime të rëndësishme.

3. Punëdhënësi mund të kombinojë vlerësimet ekzistuese të riskut nga shpërthimi, dokumente ose raporte të tjera të barasvlershme, të prodhuara në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Kërkesa të veçanta për pajisjet dhe vendet e punës

1. Pajisjet e punës për përdorim në vendet ku mund të krijohen atmosfera shpërthyese janë në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në shtojcën II.

2. Vendet e punës dhe hapësirat ku mund të krijohen atmosfera shpërthyese duhet të jenë në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Për çdo modifikim, zgjerim ose ristrukturim që kryhet në vendet e punës dhe hapësirat ku mund të krijohen atmosferat shpërthyese, punëdhënësi merr masat e nevojshme në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në këtë rregullore.

SHTOJCA I

KLASIFIKIMI I VENDEVE KU MUND TË KRIJOHEN ATMOSFERA SHPËRTHYESE

Shënim paraprak

Punëdhënësi, në bazë të rezultatit të vlerësimit të riskut, në përputhje me nenin 4, të kësaj rregulloreje, klasifikon vendet ku mund të krijohen atmosferat shpërthyese dhe vendet me atmosfera joshpërthyese.

1. Klasifikimi i vendeve

1.1 Një vend konsiderohet i rrezikshëm nëse në të mund të krijohet një atmosferë shpërthyese në shkallë të tillë, që të kërkojë masa speciale parandaluese për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve në fjalë.

1.2 Një vend konsiderohet jo i rrezikshëm nëse në të nuk pritet të krijohet një atmosferë shpërthyese në shkallë të tillë, që të kërkojë masa të veçanta parandaluese.

2. Klasifikimi i vendeve të rrezikshme

Vendet e rrezikshme klasifikohen në zona mbi bazën e shpeshtësisë dhe kohëzgjatjes së krijimit të një atmosfere shpërthyese.

Niveli i masave që duhen marrë në përputhje me shtojcën II/A përcaktohet sipas këtij klasifikimi.

Zona 0

Një vend në të cilin një atmosferë shpërthyese, e përbërë nga një përzierje me ajrin e substancave të ndezshme në formë gazi, avulli ose aerosoli, është e pranishme në mënyrë të vazhdueshme, për periudha të gjata ose shpesh.

Zona 1

Një vend në të cilin gjatë procesit normal të punës ekziston mundësia e krijimit të një atmosfere shpërthyese, e përbërë nga një përzierje me ajrin e substancave të ndezshme në formë gazi, avulli ose aerosoli.

Zona 2

Një vend në të cilin gjatë procesit normal të punës nuk ka mundësi të krijohet një atmosferë shpërthyese, e përbërë nga një përzierje me ajrin e substancave të ndezshme në formën e gazit, avullit ose aerosolit, por, nëse ajo krijohet, do të zgjatë vetëm për një periudhë të shkurtër.

Zona 20

Një vend në të cilin atmosfera shpërthyese në formën e një reje pluhuri të djegshëm në ajër

është e pranishme në mënyrë të vazhdueshme, për periudha të gjata ose shpesh.

Zona 21

Një vend në të cilin gjatë procesit normal të punës ekziston mundësia e krijimit të një atmosfere shpërthyese në formën e një reje pluhuri të djegshëm në ajër.

Zona 22

Një vend në të cilin gjatë procesit normal të punës nuk ekziston mundësia e krijimit të një atmosfere shpërthyese në formën e një reje pluhuri të djegshëm në ajër, por, nëse ajo krijohet, do të zgjatë vetëm për një periudhë të shkurtër.

Shënim

1. Shtresat, depozitat dhe grumbujt e pluhurit të djegshëm, duhet të merren në konsideratë si çdo burim tjetër që mund të krijojë një atmosferë shpërthyese.

SHTOJCA II

A. KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË TË PUNËMARRËSVE NË RISK NGA ATMOSFERAT SHPËRTHYESE

Shënim paraprak

Punëdhënësi është i detyruar të zbatojë kërkesat e përcaktuara në këtë shtojcë për:

- vendet e klasifikuara si të rrezikshme në përputhje me shtojcën I, sa herë kjo kërkohet nga veçoritë e ambientit të punës, vendeve individuale të punës, pajisjet, substancat e përdorura ose rreziku i shkaktuar nga veprimtaria e lidhur me risqet nga atmosferat shpërthyese;

- pajisjet për vende jo të rrezikshme që nevojiten dhe/ose ndihmojnë sigurimin e funksionimit të sigurt të pajisjeve të ndodhura në vende të rrezikshme.

1. Masat organizative

1.1 Informimi dhe formimi i punëmarrësve

1.1.1 Punëdhënësi informon punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre për të gjitha aspektet e mbrojtjes së punëmarrësve në risk nga atmosferat shpërthyese në vendin individual të punës.

1.1.2 Punëdhënësi informon punëmarrësin që punon në vende ku mund të krijohen atmosfera shpërthyese për dokumentin e mbrojtjes nga shpërthimi dhe udhëzimet me shkrim të proceseve të punës.

1.1.3 Punëdhënësi u siguron punëmarrësve që punojnë në vendet ku mund të krijohen atmosfera shpërthyese formim të mjaftueshëm e të përshtatshëm në lidhje me përdorimin e pajisjeve dhe mbrojtjen nga shpërthimet.

1.2 Udhëzimet me shkrim dhe lejimi i përkohshëm për të hyrë dhe/ose për të punuar në atmosferat shpërthyese

1.2.1 Punëdhënësi harton udhëzimet me shkrim të proceseve të punës në vendet e rrezikshme ku mund të krijohen atmosferat shpërthyese.

1.2.2 Punëdhënësi harton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të procesit të lejimit të përkohshëm për të hyrë dhe/ose për të punuar në atmosferat shpërthyese, me qëllim kryerjen e proceseve jo të zakonshme të punës, që lidhen me mirëmbajtjen, riparimin, pastrimin ose çdo proces tjetër dhe merr masa për zbatimin e tij.

1.2.3 Udhëzimet me shkrim përmbajnë të paktën:

a) tabelat e të dhënave të sigurisë ose të dhëna të tjera për karakteristikat e substancave të pranishme dhe të përdorura, të cilat mund të krijojnë risqe të shpërthimit;

b) karakteristikat e vendeve që paraqesin risk shpërthimi;

c) udhëzime për procesin e punës, procedurat e konfigurimit, të kontrollit dhe të testimit të sistemeve mbrojtëse, kontrolluese, matëse dhe sinjalizuese;

ç) masat për sigurinë e shëndetin në punë dhe për mbrojtjen nga zjarri, të cilat duhet të përdoren gjatë vënies në punë të pajisjeve dhe/ose ndalimit të tyre;

d) rregullat për procedurat e pastrimit;

dh) të dhëna për shtrirjen dhe periudhat e kontrollit e të testimit, si dhe ekzaminimet e tjera specifike;

e) të dhëna për shtrirjen, periudhat dhe procesin e zbulimit të krijimit të substancave të ndezshme në formë gazi, avulli, aerosoli dhe pluhuri;

ë) masat në rastin e krijimit të një atmosfere shpërthyese dhe të një risku serioz për shpërthim, përfshirë evakuimin nga vendi i punës, dhënien e ndihmës së parë dhe masat për të eliminuar pasojat e një shpërthimi;

f) listën e llojit të punëve për të cilat kërkohet leja për të punuar;

g) listën e personave përgjegjës për lejimin e përkohshëm për të punuar, sipas shkronjës "f".

1.2.4 Lejimi i përkohshëm për të punuar, duhet të përmbajnë të paktën:

- emrin dhe funksionin e personit kompetent, përgjegjës për kryerjen e punës;
- emrin dhe funksionin e personit kompetent, përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së kryer;
- listën e anëtarëve të grupit të punës që kryejnë punën;
- përshkrimin me saktësi të vendit ku do të kryhet puna;
- identifikimin e qartë të punës që do të kryhet;
- identifikimin e rrezikut, duke përcaktuar substancat e rrezikshme që mund të krijohen;
- shënjimin e vendit të punës;
- mënyrën e mbikëqyrjes;
- mënyrën e pajisjes së punëmarrësve dhe të vendit të punës me masa mbrojtëse e garantuese gjatë kryerjes së punës dhe pas përfundimit të punës;
- masat parandaluese e mbrojtëse për sigurinë dhe për shëndetin në punë dhe për mbrojtjen nga zjarri e shpërthimi;
- periudhën e vlefshmërisë së lejimit.

1.2.5 Lejimi për të punuar jepet nga një person me përgjegjësi për këtë funksion përpara fillimit të punës, i caktuar nga punëdhënësi.

1.2.6 Anëtarët e grupit të punës, të përmendur në shkronjën "c", të pikës 1.2.3, informohen me shkrim lidhur me përmbajtjen e lejimit të përkohshëm për punë, shenjat paralajmëruese që informojnë rreth rrezikut të mundshëm të shpërthimit.

1.2.7 Dokumenti "Për mbrojtjen nga shpërthimi" përmban të paktën:

- përshkrimin e vendit të punës e të zonave të punës, si: emrin e ndërtesës, llojin e impiantit, projektin e ndërtesave/dhomave dhe personat përgjegjës, numrin e punëmarrësve;
- përshkrimin e hapave dhe/ose aktiviteteve të procesit me anë të një teksti të shkurtër, mundësisht të kombinuar me një paraqitje grafike të radhës së tyre;
- përshkrimin e substancave të përdorura /parametrave të sigurisë, listën e parametrave të dobishëm të sigurisë lidhur me mbrojtjen nga shpërthimi;
- rezultatet e analizës së riskut, vendet/zonat e rrezikshme që mund të përshkruhen me anë të një teksti dhe, gjithashtu, të paraqiten në mënyrë grafike në formën e planimetrisë së zonës;
- masat teknike dhe organizative për mbrojtjen nga shpërthimi;
- zbatimin e masave të mbrojtjes nga shpërthimi, përcaktimin e personit përgjegjës e të efektshmërisë së masës;
- koordinimin e masave të mbrojtjes nga shpërthimi;
- shtojcat e dokumentit të mbrojtjes nga shpërthimi, si certifikatat e testimit CE, certifikatat CE të konformitetit, tabelat e të dhënave të sigurisë, udhëzimet e përdorimit për pajisjen apo mjetet.

2. Masat për mbrojtjen nga shpërthimi

2.1 Çdo dalje dhe/ose çlirim, qoftë i qëllimshëm ose jo, i gazrave, avujve, aerosoleve të ndezshme ose pluhurave të djegshëm, që mund të krijojë rrezik për shpërthim, duhet të devijohet ose të largohet në mënyrë të përshtatshme në një vend të sigurt ose, kur kjo nuk është e mundur praktikisht, të izolohet në mënyrë të sigurt ose të bëhet e sigurt nëpërmjet ndonjë metode tjetër të përshtatshme.

2.2 Nëse një atmosferë shpërthyese përmban disa lloje gazesh, avujsh, aerosolesh ose pluhurash të djegshëm dhe/ose të ndezshëm, masat parandaluese duhet të jenë të përshtatshme me riskun më të madh të mundshëm.

2.3 Parandalimi i rreziqeve të ndezjes në përputhje me nenin 3 të kësaj rregulloreje, merr parasysh, gjithashtu, shkarkimet elektrostatike, kur punëmarrësit ose mjedisi i punës veprojnë si mbartës ose prodhues të ngarkesave. Punëmarrësit duhet të pajisen me veshje pune të përshtatshme të bëra nga materiale që nuk prodhojnë shkarkime elektrostatike, të cilat mund të ndezin atmosferat shpërthyese.

2.4 Impianti, pajisjet, sistemet e mbrojtjes dhe çdo pajisje lidhëse ndërmjet tyre vihen në punë, vetëm nëse dokumenti "Për mbrojtjen nga shpërthimi" tregon se ato mund të përdoren në mënyrë të sigurt në një atmosferë shpërthyese. Kjo zbatohet edhe për pajisjet e punës dhe

pajisjet lidhëse që nuk konsiderohen si pajisje ose sisteme mbrojtëse, sipas kuptimit të rregullores për kërkesat teknike për pajisjet e përdorura në atmosferat shpërthyese (vendimi nr. 142, datë 11.2.2009, i Këshillit të Ministrave), nëse montimi i tyre në një instalim mund të krijojë në vetvete një rrezik ndezjeje. Masa të nevojshme duhet të merren për të parandaluar ngatërrimin ndërmjet pajisjeve lidhëse.

2.5 Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që vendi i punës, pajisjet e punës dhe çdo pajisje lidhëse ndërmjet tyre, të vëna në dispozicion të punëmarrësve, të jenë projektuar, ndërtuar, montuar dhe instaluar, mirëmbajtur dhe vënë në punë, në mënyrë të tillë që të minimizohen risqet e një shpërthimi dhe, nëse ndodh një shpërthim, të kontrollohet ose të minimizohet përhapja e tij brenda atij vendi dhe/ose pajisjeje pune. Për vende të tilla pune merren masa të përshtatshme për të zvogëluar risqet për punëmarrësit nga pasojat fizike të një shpërthimi.

2.6 Kur është e nevojshme, punëmarrësve u jepen paralajmërime optike dhe/ose akustike dhe evakuohen përpara se të jenë arritur kushtet e shpërthimit.

2.7 Kur kërkohet nga dokumenti "Për mbrojtjen nga shpërthimi", daljet për evakuimin duhet të projektohen dhe të mirëmbahen për të siguruar që, në rast rreziku, punëmarrësit të mund të largohen nga vendet e rrezikuara në kohë dhe në mënyrë të sigurt.

2.8 Përpara se vendi i punës që përmban hapësira ku mund të krijohen atmosfera shpërthyese të përdoret për herë të parë, duhet të verifikohet siguria e tij e përgjithshme ndaj shpërthimit. Të gjitha kushtet e nevojshme për të siguruar mbrojtjen nga shpërthimi duhet të ruhen. Ky verifikim kryhet nga persona që kanë eksperiencën dhe formimin e duhur profesional në fushën e mbrojtjes nga shpërthimet.

2.9 Kur vlerësimi i riskut tregon se është e nevojshme:

- në rast se ndërprerja e energjisë sjell rreziqe shtesë, të sigurohet funksionimi në siguri të plotë i pajisjeve dhe i sistemeve mbrojtëse, në mënyrë të pavarur nga pjesa tjetër e instalimit;

- të jetë i mundur komandimi manual për të fikur pajisjen dhe sistemet mbrojtëse të montuara në proceset automatike, të cilat devijojnë nga kushtet e projektuara të funksionimit, me kusht që kjo të mos cenojë sigurinë. Këto ndërhyrje kryhen vetëm nga punëmarrësit kompetentë;

- kur aktivizohet sistemi i fikjes në rast emergjence, energjia e akumuluar duhet të shpërndahet sa më shpejt dhe në mënyrën më të sigurt të mundshme ose të izolohet, në mënyrë që ajo të mos përbëjë më një rrezik.

B. KRITERE PËR PËRZGJEDHJEN E PAJISJEVE DHE SISTEMEVE MBROJTËSE

Nëse dokumenti i mbrojtjes nga shpërthimi, bazuar në vlerësimin e riskut, nuk përcakton ndryshe, pajisjet dhe sistemet e mbrojtjes për të gjitha vendet ku mund të krijohen atmosferat shpërthyese, përzgjidhen mbi bazën e kategorive të përcaktuara në rregulloren për kërkesat teknike për pajisjet e përdorura në atmosferat shpërthyese (vendimi nr. 142, datë 11.2.2009, i Këshillit të Ministrave).

Kategoritë e mëposhtme të pajisjeve përdoren në zonat e treguara, me kusht që ato të jenë të përshtatshme për gazrat, avujt, aerosolet dhe/ose pluhurat, sipas rastit:

- pajisjet e kategorisë 1 në zonën 0 ose zonën 20;

- pajisjet e kategorisë 1 ose 2 në zonën ,1 ose zonën 21;

- pajisjet e kategorisë 1, 2 ose 3 në zonën 2, ose zonën 22.

C. MASAT E VEÇANTA PËR VENDE ME RISK PËR SHPËRTHIME

Masat e veçanta të zbatueshme në vendet me atmosfera shpërthyese janë si më poshtë:

1. Ndalohet përdorimi gjatë punës i substancave dhe i pajisjeve të punës, që mund të ndezin atmosferën shpërthyese.

2. Temperatura e sipërfaqes ose e pajisjeve të punës, përfshirë instalimet dhe sistemet mbrojtëse nuk duhet të kalojë temperaturën e lejueshme, në varësi të temperaturës minimale të ndezjes të substancës së ndezshme të pranishme.

3. Nëse risku i shpërthimit nuk eliminohet është e nevojshme:

- të ndalohet puna dhe të urdhërohet evakuimi i punëmarrësve nga vendi i punës në rast të rritjes së përqendrimit të substancave të ndezshme të pranishme mbi 25% të nivelit të ulët të shpërthimit;

- të ndalohet hyrja në vendet e punës, në të cilat përqendrimi i substancave të ndezshme

rritet mbi 50% të nivelit të ulët të shpërthimit.

4. Një punëmarrës mund të lejohet:

a) për të hyrë në vende me atmosferë shpërthyese pasi të jetë siguruar oksigjeni të paktën në 19% në vëllim. Në të kundërt, punëmarrësi është i detyruar të përdorë aparatin e frymëmarrjes së izoluar;

b) për të punuar në vende me atmosfera potencialisht shpërthyese, ku përdoren pajisje të punës që mund të ndezin atmosferën shpërthyese, vetëm pas zbulimit të substancave që potencialisht krijojnë atmosferë shpërthyese dhe monitorimit të karakteristikave të mjedisit në çdo kohë gjatë punës.

5. Të shpërndahet nxehtësia që krijohet gjatë punës, në mënyrë që ajo të mos ndezë një atmosferë shpërthyese.

6. Punëdhënësi informon punëmarrësin para hyrjes në një vend me atmosferë shpërthyese, ku përqendrimi i substancave të ndezshme tejkalon vlerën maksimale të lejuar dhe e pajis me mjete mbrojtëse individuale të frymëmarrjes dhe të shpëtimit. Punëmarrësi duhet të shoqërohet (monitorohet) gjatë kësaj pune nga një punëmarrës tjetër.

7. Sigurimi i vendit të punës me teknika të përshtatshme të sigurisë dhe të ndihmës së parë.

8. Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë formim praktik për punëmarrësin përpara fillimit të punës, veçanërisht lidhur me:

a) përdorimin e aparaturës së frymëmarrjes së izoluar;

b) veprimin në situata emergjence gjatë drejtimit të makinerisë dhe zbatimit të masave për të zvogëluar pasojat negative të shpërthimit.

Modulet e formimit përcaktohen nga punëdhënësi dhe kryhen të paktën një herë në vit.

SHTOJCA III

Shenja e paralajmërimit për vendet ku mund të krijohen atmosfera shpërthyese, në bazë të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 5, të kësaj rregulloreje:

Vend ku mund të krijohet një atmosferë shpërthyese

Tipare dalluese:

- formë trekëndore;

- shkronja të zeza në sfond të verdhë me kontur të zi (pjesa e verdhë të zërë të paktën 50% të sipërfaqes së shenjës).

Rekomandohet që shenjës t'i shtohen të dhëna të tjera shpjeguese, si: klasifikimi i zonës, substancat e pranishme në mjedis, masat e nevojshme, informacion për pajisjet mbrojtëse individuale të nevojshme etj.

VENDIM
Nr. 385, datë 6.5.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË TË OBJEKTIT "SHKOLLA 8-VJEÇARE PALASË" DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 362, DATË 5.6.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË BASHKISË SË HIMARËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pasuritë e paluajtshme shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të objektit "Shkolla 8-vjeçare Palasë", sipas formularit të inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ngritjen e një qendre për të moshuarit.

2. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të

përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Prona, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, i hiqet listës së inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr. 362, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi të Bashkisë së Himarës".

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
11			Ndertese dhe truall	Shkolla 8 Vjecare, Vuno Himare	1000		Arsim 8 vjecar	Ministria Arsimit	Dr. Arsimore, Viore	Oy objekte 1 dhe 2 kate dhe siperfaqe funksionale
12			Ndertese dhe truall	Shkolla 8 Vjecare, Palase Bashkia Himare Shtat	600		Arsim 8 vjecar	Ministria Arsimit	Dr. Arsimore, Viore Bashkia Himare Funksion i perbashket	Ndertese 2 kate dhe siperfaqe funksionale Nuk eshte ne perdorim
13			Ndertese dhe truall	Shkolla Filore, L. "1 Maj", Spile Himare	100		Arsim 4 vjecar	Ministria Arsimit	Dr. Arsimore, Viore	
14			Ndertese dhe truall	Shkolla e Mesme, Spile Himare	1500		Arsim i mesem	Ministria Arsimit	Dr. Arsimore, Viore	
15			Ndertese dhe truall	Kopesht, Himare fshat Shtat	350		Arsim parashkolor	Ministria Arsimit	Dr. Arsimore, Viore	Ojysma e ndertesës vanke perdorur si ceshte. Nuk eshte ne perdorim, zene nga familiare
16			Ndertese dhe truall	Kopesht Spile Himare			Arsim parashkolor	Ministria Arsimit	Dr. Arsimore, Viore	Nertese 2 kate dhe siperfaqe funksionale
17			Ndertese dhe truall	Shkolla 4 vjecare Cepero fshat Himare			Arsim 8 vjecar	Ministria Arsimit	Dr. Arsimore, Viore	Ndertese me 2 kate dhe siperfaqe funksionale

VENDIM
Nr. 386, datë 6.5.2015

PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË UJËRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 2, e 51, pika 3, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRIJIMI I INSPEKTORATIT SHTETËROR TË UJËRAVE

1. Krijohet Inspektorati Shtetëror i Ujërave (në vijim ISHU), si institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për ujërat.

2. Ministria përgjegjëse për ujërat mbështet funksionimin efektiv të ISHU-së. Në këtë përgjegjësi nuk përfshihet drejtimi operacional i veprimtarisë së inspektimit.

II. MISIONI DHE FUNKSIONET

1. ISHU-ja ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së ujërave.

2. ISHU-ja është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën e ujërave në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për ujërat.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij kreu, ISHU-ja është përgjegjëse për çdo funksion apo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e ujërave.

4. ISHU-ja ushtron juridiksionin e vet territorial në të gjithë territorin e vendit.

III. MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE E FUNKSIONIMIT TË ISHU-së

1. ISHU-ja organizohet në dy nivele: në atë qendror dhe rajonal, ku këto të fundit janë për çdo rajon të vendit.

2. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e ISHU-së rregullohen nga ligji nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.

3. ISHU-ja drejtohet nga kryeinspektori, që është titullari i institucionit. Në kuadër të funksioneve dhe detyrave të ISHU-së, kryeinspektori ushtron këto kompetenca:

a) përfaqëson inspektoratin në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin e bashkërendimin e punës për funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së këtij inspektorati;

b) zbaton e administron buxhetin e miratuar të ISHU-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit përgjegjës;

c) nxjerr urdhra për mbarëvajtjen e vazhdueshme të punës për përcaktimin e procedurave, kompetencave, detyrave dhe funksioneve për kryerjen e veprimtarisë inspektuese të strukturave të ISHU-së në nivel qendror dhe rajonal në fushën e inspektimit të ujërave;

ç) bashkërendon veprimtarinë e ISHU-së me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën e inspektimit të ujërave;

d) siguron kontakte me organet homologe dhe organizata të ndryshme, të huaja për zgjidhjen efektive të problemeve në fushën e inspektimit të ujërave, si dhe kryen veprimtari të tjera për plotësimin e detyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin në këtë fushë;

dh) siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të ujërave;

e) ushtron çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ujërave.

4. Kryeinspektori i ISHU-së i raporton drejtpërdrejt ministrit përgjegjës për ujërat, përveçse kur ministri ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi në aparatin e ministrisë.

5. ISHU-ja në nivel qendror ka këto funksione:

a) planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit;

b) siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, në shkallë vendi;

c) informon publikun për veprimtarinë e inspektimit;

ç) jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore për veprimtarinë e inspektimit;

d) përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit;

dh) zbaton aktet ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes së rezervave ujore për menaxhimin e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore;

e) siguron zbatimin e praktikave të unifikuara të inspektimit për resurset ujore në nivel qendror dhe rajonal.

6. Përveç sa parashikohet në pikën 5 të këtij kreu, ISHU-ja në nivel qendror është përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve për të gjithë institucionin, përfshirë edhe degët në nivel rajonal.

7. Pranë ISHU-së në nivel qendror krijohet "Komisioni i ankimit të ISHU-së", i cili drejtohet nga kryeinspektori.

8. Përbërja nominale e komisionit të ankimit, procedurat për shqyrtimin e ankimeve dhe mënyra e vendimmarrjes përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin.

9. Komisioni i ankimit të ISHU-së ushtron funksionet në përputhje me afatet dhe procedurat e ankimeve, të parashikuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

10. Degët rajonale të ISHU-së ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin në qarkun përkatës. Me urdhër të kryeinspektorit, inspektorët e një dege rajonale mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe në territorin e një qarku tjetër, në bashkëpunim me degën rajonale përkatëse.

11. Degët rajonale të ISHU-së drejtohen nga drejtuesi i degës rajonale, i cili përfaqëson degën rajonale në marrëdhënie me të tretët në nivelin e qarkut përkatës dhe është përgjegjës për organizimin dhe bashkërendimin e punës për funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së degës së tij.

12. Përveç sa parashikohet në pikën 11 të këtij kreu, drejtuesi i degës rajonale:

a) jep autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit;

b) vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së autorizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin, vendos për zëvendësimin e inspektorëve gjatë inspektimit, me përjashtim të rasteve kur urdhërohet nga kryeinspektori qendror.

13. Drejtuesi i degës rajonale i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejt kryeinspektorit të ISHU-së, përveçse kur kryeinspektori ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi pranë ISHU-së në nivel qendror.

IV. STEMA DHE VULA ZYRTARE E ISHU-së

1. ISHU-ja identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

2. Stema e ISHU-së përbëhet nga stema e Republikës me shënimet: "Republika e Shqipërisë, Inspektorati Shtetëror i Ujërave".

3. Vula e ISHU-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare", të ndryshuar. Vula e ISHU-së në nivel qendror përmban edhe shënimin identifikues: "Inspektorati Shtetëror i Ujërave", ndërsa vulat e degëve rajonale përmbajnë shënimin identifikues: "Inspektorati Shtetëror i Ujërave, dega rajonale e qarkut (emri përkatës i qarkut).

4. Vula e ISHU-së dhe vulat e degëve rajonale prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

V. DISPOZITA TRANSITORE

Nëpunësit ekzistues të strukturës aktuale përgjegjëse për inspektimin e ujërave në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave transferohen pranë Inspektoratit Shtetëror të Ujërave.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 46, datë 29.1.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave", shfuqizohet për pjesën e Inspektoratit Shtetëror të Ujërave.

2. Ngarkohet ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 387, datë 6.5.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR KONTROLLIN E ASGJËSIMIT TË PCB-ve, ÇNDOTJEN APO ASGJËSIMIN E PAJISJEVE QË PËRMBAJNË PCB DHE/OSE ASGJËSIMIN E MBETJEVE TË PCB-ve TË PËRDORURA[2]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim të rregullojë asgjësimin e kontrolluar të PCB-ve, çndotjen ose asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e PCB-ve të përdorura, në mënyrë që ato të eliminohen plotësisht.

2. Për qëllime të këtij vendimi, të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim, ndërsa termat e mposhtëm nënkuptojnë:

"Asgjësim i PCB-ve", një prej operacioneve D 8, D 9, D 10, D 12 e D 15, të asgjësimit, të cilit u nënshtrohen pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, që nuk mund të çndoten (vetëm në magazinimin nëntokësor të sigurt dhe të thellë, në formacione shkëmbore të thata).

"Çndotje/rikthim në gjendjen para ndotjes", çdo veprim, përfshirë zëvendësimin me lëngje të përshtatshme, që nuk përmbajnë PCB, i cili mundëson, më pas, ripërdorimin ose riciklimin e pajisjeve.

"Pajisje që përmbajnë PCB", çdo pajisje që përmban PCB ose që ka pasur përmbajtje të PCB-ve (p.sh.: transformator, kondensator, kontejner të mbeturinave stoqe, të cilët nuk janë çndotur).

"Zotërues", personi fizik/juridik, publik ose privat, që zotëron pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe/ose PCB të përdorura brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

KREU II
DETYRAT E ZOTËRUESVE TË PAJISJEVE, OBJEKTEVE, MATERIALEVE DHE LËNGJEVE QË PËRMBAJNË PCB DHE PCB TË PËRDORURA

1. Pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të eliminohen brenda vitit 2018.

2. Për përmbushjen e afatit të përcaktuar në pikën 1, më lart, zotëruesit e pajisjeve, objekteve, materialeve dhe lëngjeve që përmbajnë PCB, duhet të marrin masa:

a) të çndotin këto pajisje nga PCB-të, në mënyrë që të mund të ripërdoren apo riciklohen;

b) të asgjësojnë, me një prej operacioneve të asgjësimit, të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB që nuk mund të çndoten dhe PCB-të e përdorura.

3. Operacionet D 8, D 9, D 10, D 12 e D 15, të asgjësimit, përcaktohen në shtojcën 1 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

4. Çndotja apo asgjësimi kryhet nga persona fizikë/juridikë, të pajisur me leje mjedisi, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, dhe me licencën III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.

[2] Ky vendim transpozon plotësisht direktivën 96/59/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 16 shtator 1996, në lidhje me asgjësimin e bifenileve të poliklorinuara dhe trifenileve të poliklorinuara (PCB/PCT) (GZ L 243, 24.9.1996, f. 0031-0035), e amenduar nga rregullorja 596/2009/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 18 qershor 2009 (GZ 188, f. 14, datë 18.7.2009) EUR-Lex – 31996L0059.

5. Çndotja apo asgjësimi është përgjegjësi e zotëruesit, i cili kontrakton person fizik/juridik të licencuar, sipas pikës 4 më lart, ose i eksporton, sipas legjislacionit në fuqi për mbetjet. Kur për asgjësim përdoret metoda e incinerimit, atëherë zbatohen kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 178, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për incinerimin e mbetjeve".

6. PCB-të e përdorura dhe pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB, përpara se të dorëzohen për t'u çndotur apo për t'u asgjësuar, mbahen larg çdo produkti të djegshëm/të ndezshëm, për të shmangur çdo rrezik zjarri.

7. Nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri në fund të vitit 2018, zotëruesit e transformatorëve që përmbajnë PCB mund t'i përdorin ata:

a) vetëm nëse PCB-të që përmbajnë përputhen me standardet teknike ose specifikimet që lidhen me cilësinë dielektrike/jopërçuese;

b) nëse janë në gjendje të mirë pune dhe nuk kanë rrjedhje.

8. Transformatorët që përmbajnë më shumë se 0,05%, në peshë, të PCB-ve, çndoten sipas kushteve të mëposhtme:

a) duke reduktuar nivelin e PCB-ve nga 0,05% deri 0,005%, të peshës;

b) duke bërë zëvendësimin me një lëng që nuk përmban PCB, i cili sjell, në mënyrë të dukshme, më pak rreziqe;

c) zëvendësimi i lëngut nuk përjashton detyrimin e zotëruesit për asgjësimin, më pas, të PCB-ve;

ç) etiketimi i transformatorit pas çndotjes zëvendësohet me etiketimin e specifikuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

9. Transformatorët, lëngjet e të cilëve përmbajnë nivelin e PCB-ve midis vlerave 0,05% dhe 0,005%, të peshës, çndoten sipas kushteve të përcaktuara në shkronjat "b" deri në "ç", të pikës 8, ose asgjësohen në fund të jetës së tyre.

10. Ndalohet:

a) ndarja e PCB-ve nga substanca të tjera, me qëllim ripërdorimin e tyre;

b) mbushja e transformatorëve me PCB mbi nivelin 0.05%, të peshës;

c) incinerimi i PCB-ve dhe/ose PCB-ve të përdorura në anije.

KREU III
INVENTARIZIMI, RAPORTIMI DHE INSPEKTIMI

1. Raportimi bëhet për pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet me vëllim PCB-je mbi 5 dm^3. Në rastin e kondensatorëve të energjisë, të ndërtuar me elemente të veçanta, si një set i kombinuar, pragu prej 5 dm^3 përllogaritet në total.

2. Zotëruesit e pajisjeve, objekteve, materialeve dhe lëngjeve që përmbajnë PCB në vëllim, sipas përcaktimit në pikën 1 më lart, dërgojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) vetëdeklarimin paraprak, i cili duhet të përmbajë informacionin, si më poshtë vijon:

a) emrin dhe adresën e zotëruesit;

b) vendndodhjen dhe përshkrimin e pajisjes;

c) sasinë e PCB-ve që përmban pajisja;

ç) datat dhe llojet e trajtimeve ose zëvendësimet e kryera dhe/ose të parashikuara për t'u kryer;

d) PCB-të e përdorura, nëse i zotëron;

dh) datën e vetëdeklarimit dhe nënshkrimin e zotëruesit.

3. Zotëruesit duhet të dorëzojnë vetë-deklarimin paraprak brenda datës 30 qershor 2016.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton inventarin paraprak për pasqyrimin e situatës aktuale të pajisjeve që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, bazuar në vetëdeklarimet e zotëruesve të tyre, brenda vitit 2016. Inventari përmban informacionin e përcaktuar në shkronjat "a" deri në "dh", të pikës 2 më lart.

5. Pas afatit të përcaktuar në pikën 3 më lart, deri në vitin 2018, pas përfundimit të afatit për çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB apo PCB të përdorura, sipas kushteve dhe kritereve të kreut II, të këtij vendimi, zotëruesit duhet të dorëzojnë vetëdeklarimin përfundimtar brenda muajit mars 2019, me këtë informacion:

a) emrin dhe adresën e zotëruesit;

b) vendndodhjen dhe përshkrimin e pajisjes;

c) sasinë e PCB-ve që përmban pajisja;

ç) datat dhe llojet e trajtimeve ose zëvendësimet e kryera;

d) kopje të dokumentacionit që provon se trajtimi apo zëvendësimi është kryer në përputhje me kriteret e përcaktuara në kreun II të këtij vendimi;

dh) PCB-të e përdorura, nëse i zotëron;

e) datën e vetëdeklarimit dhe nënshkrimin e zotëruesit.

Inventari përditësohet brenda datës 15 janar të çdo viti.

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton inventarin përfundimtar për pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB dhe PCB të përdorura, bazuar në vetëdeklarimet përfundimtare të zotëruesve të tyre, brenda vitit 2019. Inventari përmban:

a) emrin dhe adresën e zotëruesit;

b) vendndodhjen dhe përshkrimin e pajisjes;

c) sasinë e PCB-ve që përmbahet në pajisje;

ç) datat dhe llojet e trajtimeve ose zëvendësimet e kryera;

d) PCB-të e përdorura;

dh) datën e vetëdeklarimeve dhe nënshkrimin e zotëruesit.

7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit i dërgon:

a) kopje të vetëdeklarimeve paraprake, ISHMP-së, brenda datës 31 mars 2017;

b) kopje të vetëdeklarimeve përfundimtare, ISHMP-së, brenda datës 30 qershor 2019.

8. Për monitorimin e procesit, ISHMP-ja:

a) në bazë të vetëdeklarimeve paraprake, inspekton subjektet deklaruese në lidhje me emrin, adresën e zotëruesit, vendndodhjen dhe përshkrimin e pajisjeve, sasinë e PCB-ve që përmbajnë pajisjet dhe/ose PCB-të e përdorura;

b) në bazë të vetëdeklarimeve përfundimtare dhe rezultateve të monitorimit, të kryera nga AKM-ja, sipas pikës 9 të këtij kreu, inspekton subjektet deklaruese në lidhje me emrin dhe adresën e zotëruesit, vendndodhjen dhe përshkrimin e pajisjeve, sasinë e PCB-ve që përmbajnë pajisjet, dhe/ose PCB-të e përdorura, si dhe llojet e trajtimeve ose zëvendësimet e kryera.

9. Për monitorimin e ecurisë së procesit të asgjësimit dhe/ose çndotjes së pajisjeve që përmbajnë PCB e PCB të përdorura, sipas procedurave dhe detyrimeve të këtij vendimi, AKM-ja merr mostrat dhe kryen analizat laboratorike përkatëse.

10. Çdo pajisje, objekt, material dhe lëng që përmban PCB, etiketohet sipas etiketës së vendosur në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi. Etiketa vendoset, gjithashtu, në dyert e godinës ku ndodhen pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB apo ku ndodhen PCB-të e përdorura.

11. Personi fizik/juridik, që është i licencuar sipas pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi, dhe që asgjëson/çndot pajisjet, objektet, materialet dhe lëngjet që përmbajnë PCB apo PCB të përdorura, mban regjistër ku pasqyron të dhëna për sasinë, origjinën, natyrën dhe përmbajtjen e PCB-ve që i janë dorëzuar dhe procesin e asgjësimit/çndotjes, të cilit ato i janë nënshtruar. Personi fizik/juridik i dërgon informacion AKM-së, brenda 30 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të pajisjeve, objekteve, materialeve dhe lëngjeve që përmbajnë PCB apo PCB të përdorura. Formati i regjistrit dhe të dhënat që do të përmbajë ai miratohen me urdhër të ministrit.

12. Lista e emrave të prodhuesve të kondensatorëve, rezistencave dhe bobinave me induktim/përcjellshmëri, që përmbajnë PCB, miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Mjedisit dhe ministrit përgjegjës për energjinë.

13. Mospërmbushja e kërkesave të këtij vendimi përbën kundërvajtje administrative, sipas pikës 26, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

14. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCË 1
ETIKETIMI I PAJISJEVE PCB TË DEZINFEKTUARA

Çdo njësi e pajisjes së dezinfektuar duhet të shënohet qartë me një shenjë të përhershme (që nuk hiqet) dhe e gdhendur ose e stampuar, e cila duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm dhe të shkruhet në gjuhën e vendit në të cilin përdoret pajisja:

PAJISJE PCB E DEZINFEKTUAR

Lëngu që përmbante PCB është zëvendësuar

- me ..... (emri i zëvendësuesit)
- më ..... (data)
- nga ..... (sipërmarrësi)

Përqëndrimi i PCB-ve në

- lëngun e vjetër ..... % në peshë
- lëngun i ri ..... % në peshë.

SHTOJCË 2

VENDIM
Nr. 388, datë 6.5.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 118, DATË 5.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E EMËRIMIT, REKRUTIMIT, MENAXHIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL TË NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES DHE TË ANËTARËVE TË TND-së"

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 28, pika 6, 29, pika 5, 30, pika 6, 31, pika 3, e 32, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2, e kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Përfaqësuesi i DAP-it është, për shkak të detyrës, drejtori i DAP-it, i cili kryeson komisionin. Përfaqësuesi i ASPA-s është, për shkak të detyrës, drejtori i ASPA-s.".

2. Në pikën 3, të kreut II, fjalët "... dy përfaqësuesit ..." zëvendësohen me fjalët "... një përfaqësues ...".

3. Shkronja "e", e pikës 5, të kreut II, shfuqizohet.

4. Në pikën 6, të kreut II, fjala "... kandidatët ..." zëvendësohet me fjalën "... kandidatin ...".

5. Në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut IV, pas fjalëve "... kategorisë së mesme drejtuese ..." shtohen fjalët "... dhe të nivelit të lartë drejtues, në institucionet e pavarura ...".

6. Në pikën 7, të kreut VII, pas fjalëve "... të nivelit të mesëm drejtues..." shtohen fjalët "... në një institucion të administratës shtetërore ...".

7. Paragrafi i parë, i pikës 14, të kreut VII, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"14. Një anëtar i TND-së, i caktuar si koordinator i posaçëm apo në një pozicion të kategorisë së mesme drejtuese:".

8. Në pikën 15, të kreut VII, fjalët "... në pikën 13 ..." zëvendësohen me fjalët "... në pikën 14 ...".

9. Pika 16, e kreut VII, shfuqizohet.

10. Pas pikës 17, të kreut VII, shtohen pikat 18, 19, 20 e 21, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

"18. Në rast se prurjet nga ASPA dhe nga procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë nuk janë të mjaftueshme, nëpunësit e kategorisë së lartë drejtuese të institucioneve të pavarura, që kanë interes, mund të paraqesin kërkesë për t'u pranuar, drejtpërdrejt, në TND.

19. Departamenti i Administratës Publike analizon nëse nëpunësi i plotëson kërkesat e përgjithshme, kuadrin e kompetencës dhe kërkesat e posaçme, bazuar në të dhënat e shpallura në procedurën e fundit konkurruese, që është zhvilluar për këtë qëllim, brenda 30 ditëve.

20. Në rast se nëpunësi që ka bërë kërkesën i plotëson kriteret, Departamenti i Administratës Publike komunikon me njësinë përgjegjëse të institucionit të pavarur dhe, në rast të dhënies së mendimit pozitiv, nga ana e tyre, brenda 5 ditëve emëron nëpunësin në një pozicion TND-je në institucionin e administratës shtetërore.

21. Nëpunësi, që është emëruar sipas pikës 20, të kreut VII, të këtij vendimi, është i detyruar të ndjekë programin e formimit të thelluar për anëtarët e TND-së, të organizuar nga ASPA.".

11. Pika 1, e kreut VIII, ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Pranimi në kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, bëhet me konkurrim, të organizuar për një apo më shumë pozicione pune të lira, dhe është i hapur për:

a) nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese të shërbimit civil;

b) kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por, në asnjë rast, më shumë se 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese, për atë institucion. Të drejtën për të vendosur që kjo procedurë të jetë e hapur edhe për këta kandidatë e ka titullari/organi vendimmarrës i institucionit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 389, datë 6.5.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA E MADHE TIRANË" (SEGMENTI KOPSHTI BOTANIK - SAUK I VJETËR (SHTESAT)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza e Madhe Tiranë" (segmenti Kopshti Botanik - Sauk i Vjetër (shtesat)".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë "arë" dhe "truall", me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 75 195 683 (shtatëdhjetë e pesë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekësh, nga të cilat:

a) tokë "arë", me sipërfaqe 3 940 (tre mijë e nëntëqind e dyzet) m^2, me vlerë 10 331 330 (dhjetë milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë) lekë;

b) tokë "truall", me sipërfaqe 7 767.5 (shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë pesë) m^2, me vlerë 64 864 353 (gjashtëdhjetë e katër milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë tokë "arë" dhe "truall", prej 75 195 683 (shtatëdhjetë e pesë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri "Shpronësime", planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE (PËR PUBLIKIM) QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË RRUGËS "UNAZA E MADHE TIRANË", SEGMENTI "KOPSHTI BOTANIK - SAUK I VJETËR (SHTESAT)"

Nr.	PRONARI			Z. Kadastrale	Nr. i pasurie	Lloji i pasurie	Sipërfaqja (m^2)	Sipërfaqe shpronësimi (m^2)	Çmimi	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	QAZIM	HAXHI	BRARI	8270	8/324	Truall	1735	843	8,528	7,188,683	Konfirmuar
2	QAZIM	HAXHI	BRARI	8270	8/293	Truall	1265	307	8,528	2,617,943	Konfirmuar
3		B/PRONËSI BRARI		8270	8/382	Truall	65	45	8,528	383,738	Konfirmuar
4		B/PRONËSI BRARI		8270	8/292	Truall	1087	74	8,528	631,035	Konfirmuar
5	DRITA	(B.P)	SULCE	8270	8/405	Truall	281	74	8,528	631,035	Konfirmuar
6	BASHKIM	ISE	ULAJ	8270	8/404	Truall	281	101	8,528	861,278	Konfirmuar
7	LAVDIJE	FERIT	BAKALLI	8270	8/147	Truall	938	302	8,528	2,575,305	Konfirmuar
8	LAVDIJE	(B.P)	XHAJA	8270	8/146	Truall	1500	526	8,528	4,485,465	Konfirmuar
9		B/PRONËSI BRARI		8270	8/276	Truall	850	387	8,528	3,300,143	Konfirmuar
10	MEXHIT	HAMDI	BRARI	3292	153/133	Truall	320	320	8,528	2,728,800	Konfirmuar
11		B/P PETI		8280	1/394	Truall	3934.6	3191	8,528	27,211,253	Konfirmuar
12	MUHARREM	MEHMET	MUCA	3292	7/58	Are	3950	2940	2,622	7,709,165	Konfirmuar
13	DAFINA	(B.P)	POJANI	3292	354	Are	1000	1000	2,622	2622165	Bllokuar BNT
14	XHOVANE	HYSEN	GARUNJA	8280	1/86	Truall	1111.2	454	8,528	3871485	Proces konfirmimi
15	SOSE	VESEL	BOSHNJAKU	3266	75/49	Truall	880	7	2,622	18355.155	Proces konfirmimi
16	FERIT	RESHIT	BRAHJA	3266	75/75	Truall	1125	59.5	2,622	156018.8175	Proces konfirmimi
17	KRESHNIK		BRAHJA	3266	75/87	Truall	625	87	2,622	228128.355	Proces konfirmimi
18	SAMI		BRAHJA	3266	75/67	Truall	1177	25	2,622	65550	Proces konfirmimi
19	PERPARIM	SHYQYRI	HARIZI	3266	75/85	Truall	300	54	2,622	141588	Proces konfirmimi
20	NAZMI	JONUZ	PETI	8280	1/430	Truall	6000	911	8,528	7768552.5	Proces konfirmimi
	SHUMA							**11707.5**		**75,195,683**	

VENDIM
Nr. 390, datë 6.5.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT, FAKULTETI FILOLOGJIK - UNAZA E MADHE TIRANË (OBJEKT+TRUALL)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, Fakulteti Filologjik - Unaza e Madhe Tiranë (objekt+truall)".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "objekt" dhe "truall", me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 52 979 606 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekësh, nga të cilat:

a) objekt, me sipërfaqe 1 289 (një mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) m^2 dhe vlerë shpronësimi 30 357 710 (tridhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë;

b) truall, me sipërfaqe 396 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m^2, me vlerë shpronësimi 22 621 896 (njëzet e dy milionë e gjashtëqind e njëzet e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë "objekt" dhe "truall", prej 52 979 606 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e

shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri "Shpronësime", planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT" (FAKULTETI FILOLOGJIK - UNAZA E MADHE TIRANË (objekt+truall)

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi (m^2)	Sipërfaqe trualli (m^2)	Çmimi i truallit (lekë/m^2)	Vlera e truallit	Vlera e objektit	Vlera totale (lekë)	Shënime
1	Subjekti ndërtues "MAREG" Investitori Pavlin Kalusha	8160	5//84	Objekt polifunksional	1289				30357710	30,357,710	Leje ndërtimi
2	Fatos Babo +bp.	8160	5//84	Truall		396	57126	22621896		22,621,896	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	SHUMA TOTALE									**52,979,606**	

VENDIM
Nr. 391, datë 6.5.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS LIDHËSE MIDIS RRUGËVE "QEMAL STAFA" DHE "ESAT BORDI", SI DHE NDËRTIMI I LULISHTES NË PJESËN JUGORE TË BULEVARDIT "AQIF PASHA", TE "XHAMLLIKU PARA SAHATIT", NË BASHKINË E ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës lidhëse midis rrugëve "Qemal Stafa" dhe "Esat Bordi", si dhe ndërtimi i lulishtes në pjesën jugore të bulevardit "Aqif Pasha", te "Xhamlliku para Sahatit", në Bashkinë e Elbasanit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Elbasanit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqet 639.43 (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë dyzet e tre) m^2 "truall" dhe 410.77 (katërqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e shtatë) m^2 "njësi", me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 35 491 002.68 (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e dy pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 35 491 002.68 (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e dy pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Elbasanit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Elbasanit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Elbasanit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurive prej 639.43 (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë dyzet e tre) m^2 "truall" dhe 410.77 (katërqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e shtatë) m^2 "njësi", për ndërtimin e rrugës lidhëse midis rrugëve "Qemal Stafa" dhe "Esat Bordi", si dhe ndërtimin e lulishtes në pjesën jugore të bulevardit "Aqif Pasha", te "Xhamlliku para Sahatit", të bëhet në favor të Bashkisë së Elbasanit.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia e Elbasanit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LULISHTES NË PJESËN JUGORE TË BULEVARDIT "AQIF PASHA"

			Vërtetim pronësie			Truall			Njësi				Shpronësimi	
Nr.	Familja	Nr. i	m^2			shpronësim	çmimi	shpronësim	sip. e njësisë në m^2		çmimi	shpronësim	Shuma	Lloji i dokumentit të pronësisë
	që shpronësohet	pasurisë	truall	banesë	njësi	m^2	lekë/m^2	lekë	preket	shprons	Lekë/m^2	lekë	lekë	
1	Selman R.Belshaku,Valbona D.Belshaku	1/14- N.3	24.39	0.00	26.81	24.39	9460	230729.40	26.81	26.81	66140	1773213.40	**2003942.80**	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Kadri Qerim Krasniqi	1/14- N.2	0.00	0.00	23.00	0.00	9460	0.00	23.00	23.00	66140	1521220.00	**1521220.00**	Barrë hipotek. sekuestro
3	Sherife Doksani	1/14- N.11	0.00	0.00	43.50	0.00	9460	0.00	43.50	43.50	66140	2877090.00	**2877090.00**	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Sanije Tirana, Nadire Idrizi	1/14- N.10	0.00	0.00	55.00	0.00	9460	0.00	55.00	55.00	66140	3637700.00	**3637700.00**	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Jorgjie P. Beçka, Hafize B.Musabelliu	1/14- N.9	38.74	0.00	41.50	38.74	9460	366480.40	41.50	41.50	66140	2744810.00	**3111290.40**	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Arian Curri, Doloresha Perona	1/14- N.8	0.00	0.00	90.50	0.00	9460	0.00	90.50	90.50	66140	5985670.00	**5985670.00**	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Nadire Berisha (Isufaj)	1/14- N.6	73.26	0.00	73.26	73.26	9460	693039.60	73.26	73.26	66140	4845416.40	**5538456.00**	Barrë hipot. Union Bank
8	Nadire Berisha (Isufaj)	1/14- N.5	0.00	0.00	9.00	0.00	9460	0.00	9.00	9.00	66140	595260.00	**595260.00**	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Iliran I.Duka, Jonida D.Duka	1/237	24.10	0.00	24.10	24.10	9460	227986.00	24.10	24.10	66140	1593974.00	**1821960.00**	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Bukurije Sali Hoxha	1/234	24.10	0.00	24.10	24.10	9460	227986.00	24.10	24.10	66140	1593974.00	**1821960.00**	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Musa Xhepa e tjere	1/192	32.00	0.00	0.00	32.00	9460	302720.00	0.00	0.00	66140	0.00	**302720.00**	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Burbuqe Elezi (Qafmoll)etj	1/311	54.00	0.00	0.00	54.00	9460	510840.00	0.00	0.00	66140	0.00	**510840.00**	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	Bardhul Stavri	lluster	0.00	0.00	0.00	0.00	9460	0.00	0.00	0.00	66140	0.00	0.00	Nuk konfirmohet
14	Kujtim Shengjergji		0.00	0.00	0.00	0.00	9460	0.00	0.00	0.00	66140	0.00	0.00	Nuk konfirmohet
	TOTALI					**270.59**		**2559781.40**		**410.77**		27168327.80	**29728109.20**	

2. LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE E PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS LIDHËSE MIDIS RRUGËVE "QEMAL STAFA" DHE "ESAT BORDI"

			Vërtetim pronësie			Truall			Njësi				Shpronësimi	
Nr.	Familja	Nr.	m^2			shpronësim	çmimi	shpronësim	Sip. e njësisë m^2		çmimi	shpronësim	SHUMA	Lloji i dokumentit
	që shpronësohet	Pasur	truall	banese	njesi	m2	lek/m2	leke	preket	shprons	leke/m2	leke	leke	
1	Allbert Minella Buzo	8/77	545.00	214.00	0.00	32.75	7502	245690.50	0.00	0.00	68098	0.00	245690.50	Hipotekë në favor Alpha Bank
2	Merita Mehmet Qorri	8/253	263.16	67.10	0.00	256.35	7502	1923137.70	0.00	0.00	68098	0.00	4918993.50	Konfirmohet nga ZVRPP-ja
3	Merita Mehmet Qorri	8/344	100.11	0.00	0.00	79.74	7502	598209.48	0.00	0.00	68098	0.00	598209.48	Konfirmohet nga ZVRPP-ja
	TOTALI					**368.84**		**2767037.68**				0.00	**5762893.48**	

VENDIM
Nr. 393, datë 7.5.2015

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË STRUKTURAVE TË ANGAZHUARA PËR PASTRIMIN E ZONAVE BREGDETARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.1998, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, të shtohet fondi prej 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të strukturave të angazhuara për pastrimin e zonave bregdetare për sezonin turistik veror, për vitin 2015, në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

3. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të lidhin marrëveshje, në të cilën të përcaktohen zonat bregdetare që do të pastrohen, koha, mjetet dhe personeli i Forcave të Armatosura që do të vihet në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë